



Pranuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivery	15.03	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlojeç Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIPSHK	1159/2021		115	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.59/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.59/2021 të datës 04.02.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga "Rexhë Destani", pa numër në Istog, kundër Vendimit me Nr. 17/21 të datës 20.01/2021 të Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese në Dubravë/Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.03.2021, mori këtë"

V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa më numër A.nr.59/2021 e datës 04.02.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me Nr. 17/21 i datës 20.01.2021 i Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese në Dubravë/Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 276/20 i datës 19.12.2020 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- IV. DETYROHET Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e rastit të inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 13.01.2021.
- V. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi si në pikën IV të tij.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, më datë 04.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. Prot:465/2021, kundër Vendimit me Nr. 17/21 të datës 20.01/2021 të Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektues në Dubravë/Shërbimit Korrektues të Kosovës me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore largim nga shërbimi civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës më datë 08.02.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli më datë 10.02.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.02.2021 me Nr. Prot:465/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 04.02.2021 nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Vendimin me Nr. 17/21 të datës 20.01/2021 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Thirrje për intervistë e datës 13.01.2021; Vendimin me Nr. 276/20 i datës 19.12.2020 i Komisionit Disiplinor të SHKK-së; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar e datës 21.06.2018; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin i datës 19.12.2020 i Policisë së Kosovës në Istog; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Istog e datës 25.01.2021; Pasqyra nga Banka Ekonomike; Vendim me Nr. 10/21 i datës 14.01.2021 për themelimin e Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese Dubravë; Kontratën e Punës së Certifikatën e Kolegjit Biznesi për Akt Emërimin e Certifikatën e Fakultetit Juridik për Gani Sylja; Vendimin e datës 14.10.2020 për caktimin e Hivzi Sylja si zëvendësues i Zëvendës Drejtorit të Qendrës Korrektuese Dubravë; Akt Emërimin e Diplomën e Kolegjit Juridica për Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 13.01.2021 për ankuesin nga Raport Informativ i Sigurisë i datës 18.12.2020; E-mailin e datës 13.01.2021 nga Hivzi Sylja për Shkresë për gjetjet e kontrabandës tek Zyrtari Korrektues e datës 19.12.2020; Raport Informativ i Sigurisë i datës 21.09.2020 dhe 27.09.2019; Shkrese për Drejtorin; Fotot e datës 19.12.2020; Shkresë e datës 19.12.2020 nga Departamenti i Sigurimit; Raport Zyrtar i datës 19.12.2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 10.02.2021 nga SHKK.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sipas nenit 4 paragrafit 1 nëpunësit profesional të shërbimit korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, në këtë rast përveç elementeve të marrëdhënies së punës si: kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e

karrierës sipas sistemit të gradave; dhe zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, mund të ndryshoj me ligj të veçantë elementet e tjera të marrëdhënies së punës rregullohen me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës do të shqyrtoj ankesat vetëm për elementet e marrëdhënies së punës të cilat janë të rregulluara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi është i punësuar sipas kontratës për kohë të pacaktuar si personel korrektues të datës 21.06.2018 në pozitën “Zyrtar Korrektues” në Qendrën Korrektuese në Dubravë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Në bazë të raportit të incidentit të datës 19.12.2020 të përgatitur nga Of. në të cilin thuhet se: “sot më datë 19.12.2020 Departamenti i Sigurimit ka bërë bastisje të organizuar me kontroll trupore për stafin e ndërrimit të natës. Gjatë bastisjes rreth orën 07:40 në kuletën e zyrtarit korrektues është gjetur një telefon mobil i tipit UNIHERTZ, modeli JELLY PRO me nr.serik:352897092518203 (Made in China) pa sim kartelë dhe jo i mbushur me bateri. Zyrtar korrektues në momentin e bastisjes kuletën e tij nuk e ka futur në skaner me qëllim që mos ti detektohet telefoni në skaner. Për rastin është njoftuar ZV. Sylja dhe Policia e Kosovës stacioni i Policisë në Istog të cilët kanë shoqëruar për në stacion Policor zyrtarin Korrektues

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 19.12.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.276/20 me të cilin ankuesi pezullohet përkohësisht nga puna për shkak të fillimit të hetimeve për shkelje të rënda të detyrave të punës.

Më datë 13.01.2021 është iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor ndaj ankuesit me arsyetim që ka tentuar të fusë brena institucionit kontrabandë (telefon mobil), ndërsa Komisioni Disiplinor më datë 20.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 17/21 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “Largim nga Shërbimit Civil”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. 17/21 të datës 20.01.2021 të Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektues në Dubravë/Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon që konstatimet e këtij komisioni janë të pabazuara dhe pa asnjë argument kështu që si i fillë ky vendim është i kundërligjshëm.

Drejtori i Qendrës Korrektuese në Dubravë më datë 14.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 10/21 me të cilin ka themeluar Komisionin Disiplinor në Qendrën Korrektuese në Dubravë në përbërje nga: -Zëvendësues i Zv. Drejtorit-kryesues i komisionit; Udhëheqëse e Pavionit-anëtare dhe Zyrtar Ligjor-anëtar, në këtë rast Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, ka konstatuar se me dispozitat e nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, është rregulluar themelimi dhe përbërja e Komisionit Disiplinor, ku përcaktohet se: 2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1 Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2. Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësive së burimeve njerëzore – anëtar, rrjedhimisht asnjëri nga anëtarët e këtij komisioni nuk janë nëpunës nga njësia e burimeve njerëzore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, dhe duke marr parasysh frymën e funksionimit të komisioneve disiplinore vlerëson se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues si komision qendror i Shërbimit Korrektues të Kosovës duhet të shqyrtoj të gjitha rastet e procedurave disiplinore çoftë edhe nga njësitë e tij, në këtë kuptim Drejtori i Përgjithshëm është i obliguar që të shuaj të gjitha komisionet në njësitë vartëse të SHKK-së dhe të funksionoj vetëm një komision ashtu siç parashihet me nenin 49 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/LL-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë më datë 13.01.2021 nga z.

që është edhe kryesues i Komisionit Disiplinor të Qendrës Korrektuese në Dubravë, në këtë rast Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se iniciuesi i procedurës disiplinore nuk mund të jetë edhe anëtar i Komisionit Disiplinor pasi që është konflikt i pastër interesi dhe duhet të përjashtohet nga procedura sipas nenit 10 paragrafit 5 nën paragrafit 5.1 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *“Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institutucionit për raste si në vijim: Kur kryesuesi apo anëtari i komisionit është në pozitë të Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë ndaj shkelësit të dyshuar apo anasjelltas”.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se për shkak të shkeljeve procedurale në këtë procedurë disiplinore, nuk ka mund të shqyrtoj pretendimet ankimore lidhur me shkeljet e supozuara të ankuesit kështu që Vendimi me Nr. 17/21 i datës 20.01.2021 i Komisionit Disiplinor i Qendrës Korrektuese në Dubravë/Shërbimit Korrektues të Kosovës shfuqizohet sipas dispozitivit të këtij vendimi. Pas këtyre rrethanave Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës, është i detyruar të bëjë shqyrtimit e këtij rasti respektivisht shqyrtimin e iniciimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, dhe në pajtim me procedurat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i detyruar të bëjë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura, të bazohet në shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj, shkallën e fajësisë, ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera dhe përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit dhe në fund të përcaktoj dhe shqipton masën disiplinore gjithherë në raport të drejtë me shkeljen e kryer.

Kolegji thekson edhe një herë që nuk është lëshuar në trajtimin material të shkeljes së supozuara, sepse një gjë të tillë e kanë bërë të pa mundur shkeljet procedurale, prandaj ky vendim nuk e paragjykon në asnjë rrethanë vendimin përfundimtar që mund të merret në procedurë.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.59/2021

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

